Kronikë

Do shiste një automatik në Vlorë, arrestohet 17-vjeçari, kishte fshehur armën në bagazhin e taksisë! Në kërkim shoku i tij

Një 17-vjeçar është arrestuar pas një kontrolli në një automjet taksi, ku u gjet një armë zjarri automatike dhe dy krehra. Ky i ri dyshohet të ketë qenë duke tentuar të shiste armën në qytetin e Vlorës, teksa po udhëtonte me taksi në aksin Fier-Vlorë, drejt Tiranë. Policia kishte informacione më parë për taksinë në të cilën gjendej i riu me armë.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
10 Shkurt, 19:30 | **Përditesimi: 10 Shkurt, 22:04**

Share

VLORË - Operacioni, i koduar "The Passenger," ka rezultuar në kapjen e një 17-vjeçari, i cili është arrestuar pas një kontrolli në një automjet taksi, ku u gjet një armë zjarri automatike dhe dy krehra. Ky i ri dyshohet të ketë qenë duke tentuar të shiste armën në qytetin e Vlorës, teksa po udhëtonte me taksi në aksin Fier-Vlorë, drejt Tiranës. Policia kishte informacione më parë për taksinë në të cilën gjendej i riu me armë.

> *'Gjatë operacionit, në aksin rrugor "Fier-Vlorë", u kap në flagrancë dhe u vu në pranga një 17-vjeçar, banues në Fier, pasi gjatë kontrollit në bagazhin e një automjeti taksi, të cilin ky shtetas e kishte marrë për të udhëtuar drejt Vlorës, mes sendeve të tij personale, u gjet një armë zjarri automatike dhe dy krehra.', bën me dije policia.*

Gjithashtu, është shpallur në kërkim një tjetër individ, një 19-vjeçar **Ergi Gjini**, që dyshohet se ka bashkëpunuar me 17-vjeçarin për të siguruar armën e zjarrit. Pas kontrollit në shtëpinë e 19-vjeçarit, është gjetur një krehër tjetër arme, i cili është sekuestruar si provë materiale.

LEXO EDHE:
Digjen dy makina në Vlorë, dyshohet e qëllimshme! Report Tv siguron pamjet

> *'Gjatë kontrollit në banesën e shtetasit E. Gj., u gjet një krehër arme, i cili u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, së bashku me armën e zjarrit (pushkë automatike) dhe dy krehrit që transportonte 17-vjeçari.*
>
> *Vijon puna për kapjen e shtetasit E. Gj. dhe për dokumentimin e plotë të rastit.', vijon më tej policia.*

Operacioni ka vazhduar për të kapur të dyshuarin e dytë dhe për të dokumentuar plotësisht rastin.

Materialet janë dorëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Vlorës për veprime të mëtejshme ligjore.

Sekuestrohen arma e zjarrit automatike dhe 3 krehra.

G.K/Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Ergi Gjini | arme pa leje | Vlore

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A është veprim i duhur nga SPAK arrestimi i Veliajt 3 muaj para zgjedhjeve?

10 Shkurt, 23:15

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Plagoset me thikë 33-vjeçari në Vlorë, shkak një konflikt (EMRI)
10 Shkurt, 14:52

Vlorë/ I dënuar me 11,5 vite burg nga Italia për trafik droge dhe organizatë kriminale, arrestohet 60-vjeçari me dy identitete! Do ekstradohet (EMRAT+VIDEO)
10 Shkurt, 08:42

Vlorë/ Shiste kanabis në doza, vihet në pranga 32-vjeçari
8 Shkurt, 12:58

Vlorës i ngec Sahati, akrepat kanë 'ngrirë' prej 30 vitesh! Qytetarët: Është neglizhencë e bashkisë

Armand Xhelili
8 Shkurt, 12:53

Specie e rrallë në Vlorë, gjarpri i detit 2.5 metër i gjatë bie në rrjetat e peshkatarëve (VIDEO)
8 Shkurt, 10:55

'Mirror': Butrinti, 'Maldivet' evropiane me mot të ngrohtë dhe çmime më të lira se Greqia
8 Shkurt, 08:09

Vlorë/ Furgoni 'Camper' i turistit francez shkrumbohet nga flakët, e kishte parkuar në Zvërnec! Policia: Shkak dyshohet shkëndija elektrike (VIDEO)
7 Shkurt, 20:21

Kreu i Urgjencës: Epidemia e gripit ka arritur kulmin, tani presim përmirësim! Kush ka marrje fryme e temperaturë të paraqitet në spital

Armand Xhelili
7 Shkurt, 17:01

Çmontohet 'çerdhja' e prostitucionit në Vlorë! Shpallen në kërkim dy tutoret, njëra ruse, tjetra ukrainase
7 Shkurt, 14:16

SPAK mbyll hetimet, dërgon për gjykim ish-kryebashkiakun e Himarës, Jorgo Goro dhe dy ish-drejtorë
7 Shkurt, 13:34

Revista amerikane 'Travel off Path': Shqipëria ndër destinacionet e qeta mesdhetare për të vizituar në 2025
7 Shkurt, 07:53

'Po nuk u vunë pritat, Vjosa do dalë te hekurudha', erozioni lumor 'gllabëron' 60 hektarë tokë në Novoselë të Vlorës

Armand Xhelili
6 Shkurt, 16:15

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje